



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1421 / prot. 2

Tiranë, më 08/05/2020

URDHËR

Nr. 300, datë 08.05.2020

“PËR

OFRIMIN E SHËRBIMEVE STOMATOLOGJIKE NË KLINIKA/KABINETE DENTARE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të Ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të Ligjit Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

U R D H Ë R O J:

1. Hapjen e klinikave/kabineteve dentare, në të gjithë vendin, duke filluar nga data 11 Maj 2020 dhe ofrimin e shërbimeve brenda fashës orare 08:00-17:30, duke respektuar protokollat e sigurisë, të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij Urdhri.
3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e Urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Urdhri Nr. 165, datë 12.03.2020 “Për mbylljen e klinikave/kabineteve dentare” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

